



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 23 mars 2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Muharrem Nitaj, Zafir Berisha, Albert Kinolli dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Faton Topalli, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti dhe Ali Lajçi.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Shyqiri Bytyçi, Fadile Dyla, Sherif Dobra, MASHT; Bujar Bajraktari, Florim Beqiri, Safet Berisha nga ZKA-ja dhe Mentor Hyseni nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.03.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.3.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 09.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi se deputeti raportues për MASHT-në është Andin Hoti dhe sqaroi se ne kemi ndarë këto raportime në këto tematika. Më tej, kryetari ftoi përfaqësuesit e Zyrës së Auditimit të prezantojnë të gjeturat e raportit për MASHT-në.

Bujar Bajraktari, paraqiti në pika të shkurtra opinionin e dhënë të auditimit për MASHT-in, për vitin 2016, si dhe përmendi disa të gjetura kyçe.

Andin Hoti: Auditimi është fokusuar në tri çështje kryesore: Pasqyrat Financiare Vjetore, Qeverisjen dhe Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Përfundimet e nxjerra nga Raporti i Auditimit: Pasqyrat Financiare Vjetore: Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është i pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes ka ardhur si rezultat se vlera e pasurive fikse, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bartjes së pronësisë së shkollave të komunat dhe si pasojë e regjistrimit të librave në regjistrin e pasurive kapitale. Të gjeturat kryesore: Pasuritë kapitale janë të mbivlerësuara për rreth 13 mil€. Kjo ka ndodhur për faktin që shkollat e ndërtruara nga MASHT, pas finalizimit nuk ishin transferuar te komunat që janë edhe pronarë të atyre shkollave. Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës obligon MASHT-in që të afrojë falas tekstet shkollore për nxënësit e nivelit I dhe II të arsimit parauniversitar.

Bazuar në këtë, MASHT-në vitin 2016 kishte buxhetuar dhe shpenzuar 9,259,452€. Mjetet për këto tekste ishin trajtuar gabimisht si Investime Kapitale në vend se të trajtohen si Subvencione dhe Transfere, edhe përkundër kërkesave të MASHT-it drejtuar MF-së, që këto mjete të mos trajtohen si investime kapitale. Këto shpenzime ishin regjistruar në regjistrin e pasurive duke mbivlerësuar vlerën e pasurive të shpalosur në PFV. Zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak (26 rekomandime, 7 prej të cilave janë zbatuar plotësisht, 15 janë në proces të zbatimit dhe 4 tjera nuk janë zbatuar ende). Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së. Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia Sistemi i auditimit të brendshëm Planifikimi dhe realizimi i buxhetit. Pagesa e avancit në kundërshtim me ligjin e buxhetit. Menaxhimi i pagave për profesorët. Kompensimet e mësimdhënësve për provimet. Vazhdimi i kontratave kornizë. Menaxhimi i projekteve kapitale. Vonesa në realizimin e projekteve kapitale. Menaxhimi i kontratave. Po ashtu z. Hoti paraqiti edhe rekomandimet për MASHT:

MASHT-i duhet të hartojë planin e veprimit për të gjeturat e auditorit, duke caktuar personat përgjegjës dhe duke caktuar afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm të dhëna në raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2016.

Ministri duhet të sigurojë se po bëhet në mënyrë të sakët evidentimi dhe vlerësimin i saktë i pasurive kapitale dhe jokapitale.

MASHT duhet të sigurohet se kompensimi i pagave dhe mëditjeve, përveç legjislacionit tjetër në sektorin publik, rregullohet edhe me rregulloret e brendshme të Universiteteve për të ardhurat personale. Gjatë auditimit të pagave të stafit akademik, në 6 (gjashtë) Universitetet Publike, është konstatuar se në shumë raste ku rregulloret për të ardhurat personale nuk janë zbatuar me efektshmeri.

MASHT-it duhet të sigurohet se cilat janë stoqet e librave para se të behet kërkesa për libra të reja. Nga disa komuna, me rastin e hartimit të kërkesave për libra (Komunat që nuk i kanë deklaruar stoqet si Drenasi, Malisheva, Prizreni, Rahoveci, Ferizaji dhe Vitia).

Raporti i Auditimit mos të adresohet për seancë plenare, në nivel të diskutimit të mbetet vetëm në komision dhe rekomandimet të i adresohet MASHT-it.

Shyqiri Bytyçi, gjatë diskutimit të tij, sqaroi se raporti i takon periudhës në të cilën ai nuk ka qenë ministër i këtij institucioni. Ndërkaq shtoi se është i gatshëm që të marrë përgjegjësitë që kanë dalë nga ky raport i auditimit, si dhe rekomandimet që dalin nga Komisioni. Ministri Bytyçi sqaroi se një numër i madh i rekomandimeve të Auditorit janë plotësuar. Sipas tij 10 sosh janë implementuar plotësisht, ndërsa 9 janë në proces të implementimit. Ndërsa, për dy rekomandime të paplotësuara ai dha sqarime më të detajuara. Ministri ka folur edhe për mangësitë e tjera që janë hasur nga auditori gjatë asaj periudhe, duke shtuar se tashmë gjendja ka ndryshuar për të mirë.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e MASHT-it për vitin 2016, të mos adresohet për në seancë plenare, megjithatë rekomandimet t'i drejtohen ministrit të MASHT-it.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Kryetari paraqiti para deputetëve raportin përfundimtar për Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, për shqyrtim dhe miratim në lexim të dytë në Komision. Përkundër faktit se ende nuk kemi pranuar rekomandimet nga Komisioni për Integritet Evropian. Megjithatë sipas raportit të ERA-së për Kosovën, ku kërkohet që para datës 31 mars 2018, ky projektligj duhet të aprovohet në Seancë Plenare në lexim të dytë.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti përfundimtar për Projektligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, të adresohet për në Seancë Plenare për lexim të dytë.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se në mbledhjen e radhës për të mërkurën, datë 28.03.2018 kemi dy mbledhje, një në orën 11:00 me Komisionin e Buxhetit, mbledhje të përbashkët dhe në orën 13:00 po atë ditë kemi mbledhje me përfaqësuesit e Agjencisë të Privatizimit për të shqyrtuar raportin e Auditimit të AKP-së dhe Fondeve të Mirëbesimit për vitin 2016. Kërkoj po ashtu nga administrata e komisionit të përgatisë këto dy takime. Me këtë, takimi përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Kryetari i komisionit,

Stafi mbështetës i komisionit.

Driton Selmanaj